



**ALBSIG
INVEST**



**PJESË E
KASTRATI GROUP**

FONDI I PENSIONIT VULLNETAR ALBSIG

ALBSIG INVEST SHA | NUIS: L92208025J
Shoqëri administruese e fondeve të pensionit
dhe e sipërmarrjeve të investimeve kolektive

 **+355 (0) 42254764**
 **info@albsiginvest.al**
 **www.albsiginvest.al**

1. KONTRIBUTET NË FOND

- ☐ Kontributet në fond janë një grup asetesh i krijuar në bazë të një kontrate.
- ☐ Kontributet fillestare investohen dhe akumulojnë interesin e fituar.
- ☐ Pjesëmarrja në një fond pensioni përbën një alternativë kursimi të domosdoshme.
- ☐ Fondi Vullnetar i Pensionit synon të ruaj një standard jetese në momentin e daljes në pension.
- ☐ Planet e investimit mund të jenë profesionale dhe individuale apo një kombinim i tyre.
- ☐ Kontributi minimal është vetëm 1,000 Lekë. Kontributet dhe tërheqjet bëhen vetëm në monedhën Lekë.
- ☐ Komisioni i administrimit: 2.50% (më i ulët se shumica e kompanive që operojnë në treg).

2. PËRFITIMI I KONTRIBUTEVE

2.1. Si pension vullnetar shtesë

Merret shtesë nga pensioni shtetëror.

Mund të tërhiqet:

- ☐ Si pagesë e menjëhershme
- ☐ Si pagesë periodike e planifikuar
- ☐ Si kombinim i dy mënyrave të mësipërme

Realizohet në momentin kur anëtar i plotëson kushtet e parashikuara në ligj:

- ☐ Kur mbush moshën e daljes në pension
- ☐ 5 vite para mbushjes së moshës për dalje në pension
- ☐ Kur humb aftësinë për punë në mënyrë të përhershme

2.2. Si tërheqje e parakohshme

Kur tërheqja kryhet para plotësimit të kushteve të parashikuara në ligj për tërheqjen normale aplikohen penalitete mbi vlerën e aseteve.

3. INFORMACION I PËRGJITHSHËM PËR FONDIN E PENSIONIT VULLNETAR

Kontributet e investuara në fondin e pensionit dhe asetet e transferuara në Fond konvertohen në **kuotë** pensioni.

- ☐ **Vlera neto e aseteve** të fondit të pensionit dhe çmimi i kuotës llogariten dhe publikohen në bazë ditore
- ☐ Anëtarët e Fondit do të pajisen me **Prospektin e Fondit të Pensionit Vullnetar Albsig**, i cili do jetë i disponueshëm në degët e Albsig Sha si dhe pranë zyrave qendrore të Albsig Invest Sha.
- ☐ **Informacioni për fondin dhe ecurinë e çmimit të kuotës** publikohen në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë administruese www.albsiginvest.al.

- ☐ Çdo investitor pajiset me **username dhe password** dhe mund të shikojë ecurinë e llogarisë personale.
- ☐ Asetet e Fondit të Pensionit mbahen **të veçuara nga asetet e shoqërisë** Albsig Invest Sha dhe nuk mund të jenë pjesë e procedurës së falimentimit si dhe nuk mund të lihen peng apo si garanci.
- ☐ **Tirana Bank Sha** është përcaktuar si banka depozitare e licensuar nga AMF për të kryer aktivitetin e kujdestarit të Fondit të Pensionit Vullnetar Albsig.

4. RREZIQET KRYESORE

Investimet në Fondin e Pensionit shoqërohen me:

- ☐ Rrezikun e Tregut
- ☐ Rrezikun e Kredisë
- ☐ Rrezikun e Likuiditetit
- ☐ Rrezikun Operacional
- ☐ Rrezikun e Inflacionit

Rrezikun nga investimi në fond e mban vetë investitori!

5. AVANTAZHET

- ☐ Lehtësi tatimore për punëdhënësin & punëmarrësin.
- ☐ E drejta e përfitimit për pension 5 vjet përpara moshës së daljes në pension.
- ☐ Kontribute fleksibël; të trashëgueshme dhe të transferueshme.
- ☐ Përfitime në formën e pagesave periodike ose të menjëhershme.
- ☐ Kursimet në fond vullnetar shtohen për vite me radhë me një normë të kënaqshme kthimi.
- ☐ Kthimet nga investimi akumulohen në fond dhe riinvestohen bashë me kontributet.
- ☐ Investimi në fond rritet edhe gjatë periudhës së marrjes së pensionit me këste.
- ☐ Monitorimi *online* i gjendjes së llogarisë së anëtarit në faqen zyrtare të shoqërisë.
- ☐ Në faqen e internetit të shoqërisë Albsig Invest Sha sigurohet dokumentacion për fondin: Prospekt, Raport mujor, Llogaritësi i pensionit, etj

6. LEHTËSITË TATIMORE

6.1. Lehtësitë tatimore punëdhënësi

Kontributet e bëra nga punëdhënësi në interes të punëmarrësve të tij vlerësohen si shpenzim operativ, deri në shumën vjetore për çdo punëmarrës, të barabartë me 250,000 Lekë. Kjo shumë vlerësohet si shpenzim i zbritshëm për qëllime të tatimit mbi fitimin të punëdhënësit.

6.2. Lehtësitë tatimore punëmarrësi

- ❑ Kontributi i bërë nga çdo anëtar i një fondi pensioni zbritet nga të ardhurat personale të tij, për efekt tatimi mbi të ardhurat personale.
- ❑ Kufiri maksimal për lehtësitë tatimore për kontributet vjetore është vlera më e vogël që del nga krahasimi i shumës 200 000 lekë dhe 15% të të ardhurave vjetore bruto të anëtarit.
- ❑ Në rast se anëtarit është mbi 50 vjeç, kufiri maksimal për lehtësitë tatimore për kontributet vjetore është vlera më e vogël që del nga krahasimi i shumës 250 000 lekë dhe 25% të të ardhurave vjetore bruto të anëtarit.

7. INFORMACION SHITESË MBI LEGJISLACIONIN PËR PENSIONIN VULLNETAR

7.1. Penalitete në rast tërheqjeje të parakohshme

- ❑ **2%**, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer pas 20 vitesh nga data e kontributit të parë.
- ❑ **5%**, për çdo tërheqje të parakohshme kryer në periudhën kohore që fillon pas 10 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 20 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 20-të.
- ❑ **10%**, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore që fillon pas 5 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 10 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 10-të.
- ❑ **15%**, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore deri në 5 vjet nga data e kontributit të parë përfshirë edhe vitin e 5-të.

7.2. Transferimi i llogarisë individuale

- ❑ Në rastin kur anëtarit i Fondit do të transferojë asetet e tij nga një fond pensioni në një fond pensioni tjetër, të menaxhuar nga një shoqëri tjetër administruese, tarifa e zbatueshme që mbulon koston e transferimit do të jetë në nivelin 0.5% të shumës së transferuar.
- ❑ Transferimi i aseteve në Fondin e ri duhet të përfundojë jo më vonë se dita e parë e punës pas 10 ditësh pune, pasi shoqëria administruese e Fondit të mëparshëm të pensionit ka marrë njoftimin nga anëtarit.
- ❑ Transferimi nuk mund të kryhet nëse detyrimet e anëtarit ndaj Fondit të mëparshëm nuk janë shlyer.